



Asociacioni i Komunave të Kosovës

R A P O R T

nga

Takimi i Kolegjjumit për Shërbime Publike

Istog, 5 korrik 2011

Për: Ertan Munoglu – Menaxher i Programit i AKK-së

Nga: Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjumeve të AKK-së

Lënda: Raport nga takimi i Kolegjjumit për Shërbime Publike



HYRJE

Asociacioni Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim me Kryesinë e Kolegjiut për Shërbime Publike organizoi takimin e radhës të këtij Kolegjiut me 5 korrik 2011 (e martë) me fillim nga ora 11:00 në Restorantin „Trofta“ në Istog.

Takimi kishte këtë rend të ditës:

- Ndryshimi i ligjit për mbeturina,
- Rregullorja për mbeturina dhe mbrojtje të ambientit,
- Ndryshimi i ligjit për ndërmarrjet publike

Në këtë takim morën pjesë drejtorë të drejtorive të shërbimeve publike të Komunave të Kosovës, si dhe përfaqësues nga Asociacioni i Komunave të Kosovës. Takimi u kryesua nga Kryesuesi i kolegjiut të drejtorëve të Shërbimeve Publike z. Agim Haziri.

PËRMBLEDHJE

Kryesuesi në hapjen e takimit shprehu edhe një herë brengën e tij rreth pjesëmarrjes së dobët të anëtarëve në takimet e Kolegjiut si dhe angazhimin e tyre në proceset me interes për komunat. Me këtë rast Kryesuesi shprehu vërejtjet e tij sa i përket kontributit të drejtorëve komunal në debatin lidhur me shërbimet publike komunale të organizuar nga AKK gjatë Javës së Komunave. Qëllimi i këtij debati ishte të diskutohet lidhur me sfidat me të cilat përballen komunat në ofrimin e shërbimeve komunale, gjetjen e alternativave më të mira për përmirësimin e këtyre shërbimeve, etj. Të ftuar në këtë debat ishin Drejtorë të Shërbimeve Publike Komunale, përfaqësues nga ministritë e linjës, nga kompanitë regjionale të shërbimeve publike si dhe përfaqësues të organizatave partnere të AKK-së në fushën e shërbimeve publike komunale. Me këtë rast ishte një performancë e dobët e drejtorëve komunal në parashtrimin e problemeve serioze me të cilën ballafaqohen komunat në punën e tyre dhe mbrojtjen e interesave të qytetarëve.

Drejtorët do të duhet të sqarojnë se cilat janë arsyet për këto mungesa të cilat mund të paraqesin pengesë për mbarëvajtjen e punës së Kolegjiut në të ardhmen. Nga pjesëmarrësit u shtua se duhet të ketë një trysni më të madhe për prezencë më aktive si dhe një angazhim më serioz të Drejtorëve në takimet e Kolegjiut, dhe AKK duhet zyrtarisht përmes një shkrese të kërkoj nga Kryetarët e Komunave të lirojnë drejtorët për takimet e Kolegjiut.

- **Ndryshimi i ligjit për mbeturina**

Në debatin për ndryshimin e ligjit për mbeturina anëtarët e Kolegjiut diskutuan rekomandimet e Komisionit për Menaxhim të mbeturinave dhe Mbrojtje të ambientit (i cili është takur 3 herë për këtë qëllim) dhe dhanë komentet e tyre përfundimtare lidhur me këtë ligj. Bashkangjitur në **aneksin 1** janë bashkangjitur vërejtjet dhe komentet e Kolegjiut dhe ekspertit të angazhuar nga LOGOS për këtë draftligj i cili do tu përcillet përmes AKK-së zyrtarëve qeveritar për rishikim.

- **Rregullorja për mbeturina dhe mbrojtje të ambientit**

Sa i përket rregulloreve për mbeturina dhe mbrojtje të ambientit u konstatua se ato mund të ndryshohen sipas kërkesave dhe nevojave të vetë komunave, dhe me këtë rast është mirë që të paraqiten shembuj të mirë nga komunat të cilat vetëm kanë hartuar planë të tilla sikurse është komuna e Hanit të Elezit. Ky është edhe një rast i mirë në shkëmbimin e informatave dhe përvojave në përmirësimin e mëtutjeshëm të punës sa i përket mbeturinave dhe mbrojtjes së ambientit.

- **Ndryshimi i ligjit për ndërmarrjet publike**

Sa i përket ndryshimeve të mundshme të ligjit për ndërmarrje publike sipas informatave aktuale nga disa takime të Kryetarëve të Komunave me Ministrin e Zhvillimit Ekonomik është vërejtur se janë propozuar vetëm disa ndryshime të vogla të cilat mund të konsiderohen kozmetike dhe jo në bazë të kërkesave të AKK-së. Meqenëse nuk ekziston një draft i këtij ligji Kolegjiut vendosi që për këtë çështje të diskutohet kur të dorëzohet një versioni i tillë.

KONKLuzionET

- AKK të dërgojë një shkresë tek Kryetarët dhe Drejtorët relevant rreth pjesëmarrjes së ulët në takimet e Kolegjiut
- AKK të dërgojë komentet e Kolegjiut mbi ligjin për mbeturina në Qeveri.